



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:041634
Datë: 06.03.2024
Numri i dokumentit: 05420043

PPP.nr.16/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Sami Gashi, me bashkëpunëtoren profesionale Rona Myftiu, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditori të përmbarimit E.M., nga fshati Krushë e Vogël, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av B.K., kundër debitorit të përmbarimit, S.D., nga fshati Korishë, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.H., nga Prizreni, për përmbarimin e dokumentit të përmbarimit – Pajtimi Gjqësor C.nr.1247/2019 të datës 16.09.2019, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 100,000.00 (njëqind mijë) eurove, dhe shpenzimeve të përmbarimit dhe i lejuar me Urdhrin për përmbarim, P.nr.486/19 të datës 31.10.2019 të Përmbaruesit privat, Sefer Arifi nga Gjilani, duke vendosur sipas kërkesës së palës debitore të datës për shtyrjen e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 06.03.2024, mori këtë :

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar** kërkesa e debitorit të përmbarimit S.D., nga fshati Korishë, Komuna e Prizrenit e datës 30.11.2023.
- II. SHTYHET** përmbarimi në këtë çështje juridike përmbarimore për periudhën prej 6 (gjashtë) muaj, sipas urdhërit për përmbarim P.nr.486/19 të datës 16.09.2019.

A r s y e t i m

Përmbaruesi privat, S.A., nga Gjilani, si organ i përmbarimit, me Urdhërin për përmbarim, P.nr.486/19 të datës 16.09.2019, ka lejuar propozimin për përmbarim të kreditorit të përmbarimit E.M., nga fshati Krushë e Vogël, Komuna e Prizrenit, kundër debitorit të përmbarimit, S.D., nga fshati Korishë, Komuna e Prizrenit, dhe atë për përmbarimin e dokumentit të përmbarimit – Pajtimi Gjqësor C.nr.1247/2019 i datës 16.09.2019, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 100,000.00 eurove (njëqind mijë) eurove dhe shpenzimeve të procedurës përmbarimore. Kundër këtij urdhri për përmbarim, pala debitore ka paraqitur prapësim, duke propozuar që të aprovet prapësimi dhe të anulohet urdhri i përmbaruesit

privat, P.nr.486/19 i datës 31.10.2019 më gjerësisht si në prapësim, derisa në prapësimin e palës debitore, kreditori i përmbarimit, ka paraqitur përgjigje në prapësim përmes të cilës ka kontestuar në tërësi prapësimin e debitorit me pretendimin që debitori nuk është mbështetur në asnjë nga kushtet e parapara për paraqitjen e prapësimit andaj ka kërkuar që i njëjti të refuzohet.

Gjykata me Aktvendimin PPP.nr.512/2019 të datës 20.11.2019 ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit.

Pala debitore me datë 30.11.2023 nëpërmjet përmbaruesit privat S.A., nga Gjilani, ka parashtruar kërkesën për shtyrjen e përmbarimit dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani, duke përfshirë edhe lirimimin e llogarive bankare, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes në fjalë. Debitori kërkesën e tij e ka bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr. 233/23 të datës 30.10.2023 me të cilën është aprovuar në tërësi kërkesëpadia e paditësit – këtu debitorit të përmbarimit S.D., nga fshati Korishë, dhe është anuluar Ujdia Gjyqësore C.nr.1247/19 e datës 16.09.2019, që në këtë procedurë përmbarimore është dokument përmbarimor sipas Urdhrit për Përmbarim P.nr.486/19 e datës 31.10.2019.

Kreditore me datë 12.12.2023 ka parashtruar përgjigjen ndaj kërkesës së debitorit për shtyrjen e përmbarimit, me pretendimet se kërkesa e debitorit nuk është e mbështetur në asnjë nga kushtet e parapara në nenin 35 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore. Kreditore në përgjigjen e tij ka paraqitur si provë Ankesën në Gjykatën e Apelit lidhur me Aktgjykimin C.nr.233/23 të datës 30.10.2023.

Kjo gjykatë pas shqyrtimit të kërkesës së debitorit të përmbarimit, për shtyrjen e përmbarimit në çështjen juridike të përmbarimit, P.nr.486/19 për shtyrjen e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit dhe parashtrësës së palës kreditore sa i përket deklarimit të palës kreditore për kërkesën e palës debitore për shtyrjen të përmbarimit, vlerësoi se kërkesa e debitorit të përmbarimit për shtyrjen e përmbarimit, është e bazuar, dhe atë për këto arsye:

Në nenin 61 të LPP-së, që i referohet shtyrjes së përmbarimit sipas kërkesës së debitorit, aty, thuhet: *“Në qoftë se debitori argumenton se zbatimi do t'i shkaktojë atij dëm të pariparueshëm, organi përmbarues plotësisht ose pjesërisht do të shtyjë përmbarimin kur: është parashtruar ankesë kundër dokumenti përmbarues dhe pala ankuese i demonstron Gjykatës së shkallës së parë se ka mundësi bindëse për të qenë e suksesshme në ankesë, ...”*. Në rastin konkret, me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.233/23 të datës 30.10.2023, është aprovuar në tërësi kërkesëpadia e paditësit – këtu debitorit të përmbarimit dhe Ujdia Gjyqësore C.nr.1247/19 e datës 16.09.2019 është anuluar, që në këtë procedurë përmbarimore është dokument përmbarimor sipas urdhrit për përmbarim P.nr.486/19. Në nenin 61 par. 4 të LPP-së parashihet: *“Organi përmbarues mund plotësisht ose pjesërisht ta shtyjë përmbarimin në situata ku debitori dëshmon përmes dokumenteve publike ose të vërtetuara se përmbarimi do t'i shkaktojë dëm të pariparueshëm... ”*.

Në rastin konkret, Gjykata vlerësoi që kërkesa e debitorit të aprovohet, pasi që i njëjti ka dëshmuar përmes: Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.233/23 me të cilën është anuluar në tërësi Ujdia Gjyqësore, e që në këtë procedurë përmbarimore është dokument përmbarimor e që në rastin konkret po të zhvillohet procedura e përmbarimit të njëjtit do të i shkaktohet dëm. Andaj nga këto arsye të cekura si më lartë, Gjykata aprovoi kërkesën e debitorit për shtyrjen e përmbarimit në periudhë 6 (gjashtë) mujore duke u bazuar

në nenin 63 par.1 të LPP-së: “1. Organi përmbarues mund të shtyjë përmbarimin në bazë të nenit 61 dhe 62 të këtij ligji për kohën të cilën e vlerëson të arsyeshme duke i marrë parasysh rrethanat e rastit konkret, por jo më gjatë se gjashtë (6) muaj, përveç në rastet kur vlen paragrafi 3. i këtij neni.”. Ndërsa sa i përket kërkesës së debitorit për lirimin e llogarive bankare, gjykata nuk u lëshua në këtë kërkesë, pasi që me kërkesën për shtyrje të përmbarimit, shtyhet ekzekutimi i dhunshëm përmbarimor, në rastin konkret për periudhën 6 mujore, ndërsa veprimet e ndërmarra paraprakisht nga organi përmbarimor mbesin në fuqi përgjatë kësaj periudhe, sepse po të liroheshin llogaritë bankare dhe të anulohen veprimet paraprake të organit përmbarues, atëherë debitori do të mundet të disponojë me pasurinë e tij dhe përmbarimi do të pamundësohej.

Me arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë vendosi që të aprovojë kërkesën e debitorit të përmbarimit, S.D., nga fshati Korishë, Komuna e Prizrent për shtyerjen e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 61 dhe 63 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
PPP.nr.16/2024, datë 06.03.2024

Gjyqtari,
Sami Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet mjeti i goditjes .